



## Komunikatë për Media

Prishtinë – 20 Dhjetor 2018

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM është Agjenci e Pavarur e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. KPMM rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-158 (tash e tutje LMM), me aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me këtë ligj, dhe Strategjinë Minerare. KPMM vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas LMM-së.

KPMM mbikëqyret nga Bordi i cili përbëhet prej 5 anëtarëve, të cilët sipas legjislacionit në fuqi kanë mandat 5 (pesë) vjeçar. Me pjesën ekzekutive të KPMM-së udhëheq Drejtori i cili ka mandat 3 (tre) vjeçar, si dhe Kryeinspektori i cili udhëheq Inspektoratin e Minierave. Struktura dhe stafi tjetër i KPMM-së, përbëhet nga departamentet kryesore me staf profesional dhe njësitë tjera mbështetëse me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në KPMM gjatë vitit 2017 ishte 76 të punësuar.

KPMM gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsejtë 32 takime të rregullta të Bordit , pastaj është organizuar Konferenca për promovim të sektorit minerarë Kosovë Shqipëri, si dhe aktivitete të tjera të cilat janë paraqitur me poshtë.

### Aplikacionet për licenca dhe leje:

Aplikacione të pranuar nga KPMM-ja gjatë vitit 2018 janë gjithsejtë 257 aplikacione për licenca dhe leje. Nga ato 106 për licencë të hulumtimit, 49 të shfrytëzimit dhe 102 Leje për aktivitete të veçanta.

Të shqyrtuara janë 346 aplikacione për licenca dhe leje, nga ato 124 hulumtim, 94 shfrytëzim dhe 128 leje për aktivitete të veçanta (arsye pse ka me shumë aplikacione të shqyrtuara se sa numri i aplikacioneve është se ka pasur aplikacione nga viti 2017 si dhe disa aplikacione janë shqyrtuar më shumë se një herë) .

Tabela 1: Aplikacionet për leje të veçanta gjatë vitit 2018

Lejet për aktivitetet te veçanta të aprovuara- lëshuara	77
Bazë Asfalti	6
Bazë Betoni	32
Sortues (bazë separacioni)	39
Aplikacione të pranuar dhe të refuzuara	25
Aplikacione të aprovuara, por leje të pa tërhequra	26
<b>Gjithsejt të shqyrtuara</b>	<b>128</b>

Tabela 2: Aplikacionet për licenca të hulumtimit gjatë vitit 2018

Licenca të lëshuara për hulumtim	88
Guri I Fortë	53
Material industrial	6
Minerale metalike	20
Rërë dhe zhavorr	7
Thëngjill dhe Bitumen	2
Aplikacione të pranuar dhe refuzuara gjatë vitit 2018	18
Licencat e aprovuara, të patërhequra	18
<b>Gjithsejt të shqyrtuara</b>	<b>124</b>

Tabela 3: Aplikacionet për licenca të shfrytëzimit gjatë vitit 2018

Licencat e lëshuara për shfrytëzim	34
Guri i fortë	29
Material industrial	1
Rërë dhe zhavorr	4
Aplikacione të pranuar dhe refuzuara gjatë vitit 2018	10
Licenca të aprovuara , të patërhequra	16
<b>Gjithsejt të shqyrtuara</b>	<b>94</b>

Ndryshimi në mes të aplikacioneve, të pranuar gjatë vitit 2018 dhe licencave të aprovuara – lëshuara arsyetohet me faktin se gjatë vitit 2018, janë aprovuar dhe lëshuar edhe licenca të shfrytëzimit të cilat kanë aplikuar gjatë vitit 2017.

#### **Inspektimet:**

**Inspektorati i KPMM-së gjatë vitit 2018 ka pasur një dinamikë të lartë pune të vizitave dhe inspektimeve në terren.**

Tabela 4: Inspektimet gjatë vitit 2018

Inspektime të rregullta	26
Inspektime Ad-hoc	275
Inspektim I fushave paraminuese	547
Inspektim I fushave minuese	482
Inspektime të shfrytëzimeve ilegale	97
Sekuestrim I Lignitit dhe rërës dhe Zhavorrit	16
Inspektime tjera	214
<b>Gjithsejt inspektime</b>	<b>1657</b>

Sa i përket konfiskimeve Inspektorati KPMM-se në inspektimet e përbashkëta me MMPH-në kanë konfiskuar 14 kamionë (2 dhe 10 tonësh) si dhe nga Inspektorati i KPMM-së janë sekuestruar dy transportues të mëdhenj me rërë.

Është bërë prazantimi i përbashkët i broshurës informative për veprimet ilegale (të jashtëligjshme) me Departamentin e Hetimeve për Krimeve të Rënda dhe MMPH-në në të gjitha rajonet e Republikës së Kosovës (gjithsejt 8)

Mesazh kundër dukurisë së operimeve ilegale në sektorin minerarë në vitin në vijim që kjo dukuri të ndërprehet është:

Lufta ndaj operuesve të jashtëligjshëm do të intensifikohet edhe në vitin 2019, prandaj i ftojmë institucionet relevante që të vazhdohet me përkrahje në aksionet tona si dhe ato të përbashkëta. Marrja e detyrave konkrete në raste të sekuestrimit nga Policia e Kosovës është një ndihmesë konkrete që na duhet për vitin 2019 si dhe ndarja e hapësirave nga Komunitat për të vendosur materialin e sekuestruar. Ndihmë të konsiderueshme presim edhe nga organet e Gjyqësorit duke vepruar drejtë për drejtë në sekuestrimin dhe konfiskimin e makinerive sipas kallëzimeve penale pasi që shumica prej këtyre operatorëve të jashtëligjshëm kanë më shumë se 10 raporte të shfrytëzimit ilegal.

Gjatë vitit 2018 KPMM-ja ka përcjellë në prokurori **87 kallëzime penale** kundër operuesve ilegal në sektorin e minierave. Deri në fund të vitit ky numër do të rritet sepse ka edhe disa raste të cilat do të dërgohen.

**KPMM-ja është organi përgjegjës për vlerësimin dhe arkëtimin e rentave minerare, taksat dhe gjobat administrative. Në tabelën më poshtë janë të pasqyruara të hyrat për vitin 2018.**

Tabela 5: Të hyrat për vitin 2018

Nr. Rendor	Përshkrimi	Te Hyrat 2018
1	Taksat Administrative	367,539.98
2	Gjobat Administrative	338,173.48
3	Renta Minerale	25,039,531.99
4	Të hyrat nga Kompania e Sigurimeve	
5	Depozitat	25,000.00
6	Kthimet	-4,300.00
	Totali	25,765,945.45

## Objektivat 2019

KPMM, parasheh që të rris efikasitetin dhe efektivitetin e detyrave dhe përgjegjësi të veta duke vazhduar përmes ngritjes së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të qeverisjes në përgjithësi dhe objektivave të caktuara në veçanti:

- Implementimi i Legjislacionit minerar, politikave dhe strategjisë minerare
- Licencimi i ndërmarrjeve minerare në harmoni me LMM, planin për menaxhimin e resurseve minerale, Strategjinë minerare dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve minerale
- Monitorimi – inspektimi si dhe zbatimi i të gjitha Ligjeve që ndërlidhen me sektorin minerarë nga ana e ndërmarrjeve të licencuara, si dhe zbatimi i Planit të veprimit për parandalimin dhe ndalimin e operuesve të jashtëligjshëm
- Tërheqja e Investitorëve përmes promovimeve të potencialit mineral që ka dhe ofron Kosova
- Ngritja e nivelit të transparencës, komunikimit dhe avancimi i sistemit të teknologjisë informative për të mundësuar punë më efektive në KPMM dhe ofrim të shërbimeve për investitorët, kompanitë dhe qytetarët.
- Parandalimi dhe ndalimi i ekonomisë joformale në fushën e Minierave.

## Sfidat në të ardhmen

Duke marr parasysh të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me LMM-në dhe rregullat tjera në përgjithësi, në njërin anë, ndërmarrjen e aktiviteteve për zbatimin e tyre në praktikë dhe konceptet mbi trendet zhvillimore për këtë fushë, mund ta konsiderojmë si sfidë të veçantë për institucionet e RKS-së dhe gjithësesi sfidë për vet KPMM-në. Si sfida për arritjen e objektivave të parapara në të ardhmen, ne mund të veçojmë:

- Miratimi i Ligjit për Miniera dhe Minerale (me ndryshime) do të krijoj siguri dhe lehtësime për kompanitë e interesuara për investime në sektorin minerarë në Republikën e Kosovës.
- Parandalimi i ekonomisë joformale (parandalimi dhe ndalimi i aktiviteteve minerare të jashtëligjshme, operimeve ilegale) si dhe sekuestrimi i mjeteve dhe lëndëve minerale të tyre.
- Ngritja e kualitetit dhe sigurisë në punë në operimet minerare. Edhe pse funksionimi i sektorit minerar në Kosovë shoqërohet me siguri të mirë, prapë se prapë për Inspektoratin e Minierave mbetet sfidë që në bashkëpunim me institucionet relevante të përvetësojë dhe zbatoj standardet teknike dhe të sigurisë që zbatohen në vendet e BE-së.
- Mostrajtimi në kohë i lëndëve të paraqitura në gjykata. Sankcionet Penale të shqiptuara nga Gjykatat nuk po e arrijnë efektin e parandalimit të operimeve të jashtëligjshme.

- Hartimin dhe aprovimin e akteve nënligjore të nevojshme dhe domosdoshme për implementimin e LMM-ës.
- Implementimi i vazhdueshëm i aktiviteteve që rrjedhin nga zbatimi i Strategjisë minerare dhe Planit për Menaxhimin e Resurseve Minerale.
- Implementimi i vazhdueshëm i aktiviteteve që rrjedhin nga zbatimi i politikave minerare.

Me respekt nga:

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Tel: +381 (0) 240 252

Fax: +381 (0) 245 844

E-mail: [icmm@kosovo-mining.org](mailto:icmm@kosovo-mining.org)

Web: [www.kosovo-mining.org](http://www.kosovo-mining.org)

Adresa: Armend Daci Nr.1

Prishtinë, Republika e Kosovës